



## **Promovohet libiri “Sedefkar Mehmet Agai “, arkitekt me origjinë shqiptare që ndërtoi Xhaminë Sulltanahmet**

Qendra Kulturore në Stamboll ishte nikoqire e promovimit të librit “Sedefkar Mehmet Agai” i autorit Bülent Sapankaya.

Libri bën fjalë për arkitektin e njohur Sedefkar Mehmet Agai me origjinë shqiptare që ka jetuar gjatë kohës së Perandorisë Osmane dhe ka ndërtuar Xhaminë Sulltanahmet e njohur edhe si Xhamia Blu në Stamboll.

Xhamia Blu llogaritet si një mrekulli që ka gjashtë minare dhe është një ndër atraksionet kryesore turistike në Stamboll

U.D. Drejtori i Qendrës Kulturore të Kosovës në Stamboll, Qamil Bytyçi tha se arkitekti Sedefkar Mehmet Agai njihet se është me prejardhje Shqiptare. “Por është me rëndësi që origjinën e tij shqiptare ta vërtetojë në veprën e tij një studijues nga Turqia”, shtoi më tej z. Bytyçi.

Autori i veprës, Bülent Sapankay theksoi se është një fatkeqësi që deri tani nu kështë shkruar asnjë vepër për një figurë aq të madhe si arkitekti Sedefkar Mehmet Agai e që është edhe krijuesi i një mrekullie të arkitekturës së vjetër si Xhamia Blu në Stamboll.